


DECENTRALIZIMI

NJË PESHË E RËNDË PËR TA REALIZUAR

Përpjekjet për të lëvizur nga konsolidimi i demokracisë lokale në ofrim më të mirë të shërbimeve

Rasti i Kosovës



Author: **Besnik Tahiri**
KLGJ Drejtor Ekzekutiv

Një studim mbi perspektivën dhe sfidat e decentralizimit
në Republikën e Kosovës tri vite pas miratimit të Kushtetutës

5 korrik 2011

Impressum

Botues:

Friedrich-Ebert-Stiftung

Zyra Redaktuese:

Friedrich-Ebert-Stiftung Prishtina Office, Kosovo

Rr.Mujo Ulqinaku 4/App 10

Tel: +381 38 243785, 220390

Fax: +381 38 220192

Email: contact@fes-prishtina.org

www.fes-prishtina.org

Radhitja:

Studio FORMA

Printimi:

Studio FORMA

Dizajni I kopertinës:

Shpëtim Ahmeti

Data e botimit: Korrik, 2011

Vendi i botimit: Prishtinë

E drejta autoriale Friedrich-Ebert-Stiftung

Ky raport nuk paraqet qëndrimet e Friedrich Ebert Stiftung

Përmbajtja

Shkurtesat	4
<i>Metodologjia</i>	5
Falënderimet	5
Për Institutin Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI)	5
Përmbledhje	6
Decentralizimi i Komunave të Reja	9
Hyrje	9
Progresi në Komunën e Graçaniçës	11
Progresi në Ranillug	12
Progresi në Komunën e Klllokotit	14
Progresi në Komunën e Parteshit	15
Progresi në Komunën e Novobërdës (komunë e zgjeruar)	16
Progresi në Mitrovicën e veriut	16
III. Efektet e decentralizimit në ofrimin e shërbimeve lokale	19
Hyrje	19
Autonomia në ofrimin e shërbimeve	20
Financimi për ofrim të shërbimeve	26
Performanca në ofrim të shërbimeve	28
Potenciali për bashkëpunim ndër-komunal	31
Përfundim	33
Rekomandimet	35
Bibliografia	36

Shkurtesat

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
AKP	Agjencia Kosovare për Privatizim
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
AMP	Agjencia për Mbrojtjen e Pyjeve
BB	Banka Botërore
KE	Këshilli i Evropës
EPK	Ekipet Përgatitor Komunale
GNMD	Grupi Ndërmintor i Decentralizimit
ICG	Grupi Ndërkombëtar i Krizave
IPA	Instrumenti për Asistencë dhe Partneritet
KE	Komisioni Evropian
LFK	Ligji për Financa Komunale
LKK	Ligji për Kufij Komunal
LOGOS	Programi Zviceran për Përkrahje të Qeverisjes Lokale
LVQL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NPR	Ndërmarrje Publike Rajonale
OJQ	Organizatë Jo-qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
ZCN	Zyra Civile Ndërkombëtare

Metodologjia

Ky studim është rezultat i hulumtimit kuantitativ dhe kualitativ të Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale. Të dhënat janë mbledhur nga burimet primare dhe sekondare të mbledhura nga vizita të ndryshme në terren, sikurse edhe përmes punëtorive dhe diskutimeve me përfaqësues komunal dhe qeverisë qendrore, përfshirë edhe MAPL-në. Konsultimet me organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e komuniteti ndërkombëtar po ashtu kanë shërbyer si input i rëndësishëm për këtë raport. Përveç kësaj, gjatë katër muajve të fundit (shkurt – maj 2011) KLGI ka bërë një analizë të të gjitha raporteve relevante të publikuara nga agjencitë qeveritare – p.sh. raportet e progresit nga MAPL – sikurse edhe nga komuniteti ndërkombëtar. Ky punim është vazhdimësi e punës së bërë vitin e kaluar kur KLGI ka publikuar punimin “Decentralizimi: i qartë në letër, i turbullt në praktikë” që ishte pasuar me një konferencë në të njëjtën temë.

Falënderimet

Dëshiroj të falënderoj Friedrich Ebert Stiftung (FES) që e ka bërë të mundshëm këtë punim dhe për vazhdimin e përkrahjes së projekteve që ndihmojnë avancimin e proceseve demokratike dhe efikase në Kosovë. Mirënjohje e veçantë shkon për hulumtuesin e lartë Jetmir Bakija dhe Fatmir Haxhollin për komentet dhe kontributin e tij. Po ashtu dëshiroj të falënderoj edhe Robert Daughters redaktimin në gjuhën angleze.

Në fund, dëshiroj të shpreh falënderimin tim për të gjithë Kryetarët, zyrtarët e MAPL-së, zyrtarët e organizatave donatore ndërkombëtare dhe OJQ-të që ishin të gatshëm të kontribuojnë në këtë studim përmes intervistave dhe diskutimeve me ne.

Për Institutin Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI)

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI) është një institut kërkimor lokal i përkushtuar për analiza dhe studime që kontribuojnë në praktika efikase të qeverisë lokale në Republikën e Kosovës. KLGI është e përkushtuar për të përkrahur procesin e reformës së qeverisjes lokale dhe të jetë një instrument për të funksionalizuar decentralizimin. Aktivitetet kryesore të KLGI në tri vitet e fundit kanë qenë të lidhura me qeverisjen lokale dhe zhvillimin, hulumtimin, ndërtimin e kapaciteteve dhe programeve trajnuese për strukturat e qeverisjes lokale.

Përmbledhje

Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë përdorur reformat e decentralizimit si një mjet për të gjetur zgjidhje për çështjet kombëtare që kanë dalë si pasojë e konflikteve ndëretnike dhe si nevojë për të zvogëluar kompetencat e tepruara të centralizimit të trashëguara nga regjimet e mëparshme socialiste. Në anën tjetër, decentralizimi mund të jetë një proces kundërthënës. Gjatë zbatimit, qeveritë qendrore ngurrojnë të bartin pushtetin me argumentin se qeveritë lokale akoma nuk janë në gjendje që t'ia dalin me kompetencat e reja të tyre, në anën tjetër, komunat kërkojnë më shumë përgjegjësi në mënyrë që t'i përmbushin kërkesat e qytetarëve për ofrim të shërbimeve. Faktet e decentralizimit në Kosovë tri vite pas aprovimit të Kushtetutës tregojnë se kjo reformë publike është një proces afatgjatë dhe jo një intervenim që mund të arrihet plotësisht në një afat kohor të caktuar nga vendimmarrësit vendor apo faktori ndërkombëtar. Deri më tani, decentralizimi ka pasur efekte pozitive, sidoqoftë, suksemi i decentralizimit do të varet në rend të parë nga dy faktorë kryesorë: përkrahja e qeverisë qendrore dhe reagimi i duhur i qeverive lokale dhe qytetarëve. Për më tepër, organizatat ndërkombëtare donatore të cilat e kanë shtyrë aq shumë këtë proces në fillim, akoma kanë punë për të kryer, veçanërisht me resurse dhe intervenime konkrete.

Megjithatë, ka një anë tjetër të decentralizimit e cila është më pak politike e më shumë praktike. Qëllimet e decentralizimit shkojnë përtej parimeve të gjëra të vetëqeverisjes dhe përfaqësimit politik të komuniteteve lokale. Ato po ashtu kanë për qëllim që shërbimet publike t'i ofrojnë më afër qytetarëve, duke u siguruar që të njëjtat janë të ofruara më efikasitet dhe më përgjegjshmëri në mënyrë që t'u shkojnë për shtati nevojave të komunitetit lokal dhe përmirësojnë jetën dhe mirëqenien e njerëzve që jetojnë atje. Pikërisht këto janë sfidat aktuale të decentralizimit në Kosovë; qëllimet politike të decentralizimit nuk mund të përmbushen në mënyrën e duhur pa pasur vëmendjen tek ofrimi efikas i shërbimeve publike. Në këtë aspekt, ky punim përqipet të tregoj dhe analizoj procesin e decentralizimit në Kosovë, sukseset dhe sfidat, duke u fokusuar në dy fusha kryesore: krijimi i komunave të reja dhe efikasiteti i shërbimeve lokale – tri vite pas inicimit të procesit të decentralizimit.

Përparimi kryesor i decentralizimit vitin e kaluar ka qenë konsolidimi i komunave të reja. Këto komuna kanë bërë përparime konkrete në konsolidimin e administratave të tyre dhe në marrjen e përgjegjësi të dhëna atyre së bashku me statusin e ri. Në të njëjtën kohë, institucionet ilegale paralele akoma funksionojnë në këto lokalitete duke paraqitur kështu një sfidë në autonominë e plotë të qeverive lokale legale atje. Në veçanti, në fushën e arsimit, pasi që mësuesit paguhën nga Beogradi dhe janë nën urdhërat e Beogradit, autoritetet kosovare nuk mund të zbatojnë plan-programin e Kosovës në këto komuna e as që mund të bëhet ndonjë bashkëpunim ndërmjet shkollave lokale dhe autoriteteve kosovare që janë përgjegjëse për arsim në pjesën tjetër të vendit. Në njërin nga komunat e synuara, Mitrovicën e Veriut, vështirësitë janë më të dukshme. Zbatimi i dispozitave të dizajnuara në planin e Ahtisaarit, të shndërruara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, nuk janë përmbushur ashtu siç janë planifikuar. Kanë qenë disa përpjekje konkrete në vitin 2009 nga MAPL për të qar përpara krijimin e Mitrovicës së Veriut. Megjithatë, zgjedhjet për këtë komunë janë shtyrë në dy raste për shkak të vullnetit politik, ndërhyrjeve nga strukturat paralele ilegale të Serbisë dhe mungesës së interesit dhe asistencës nga komuniteti ndërkombëtar. Kjo është rikonfirmuar edhe nga fakti që Strategjia e Qeverisë për Integrimin e Veriut është braktisur për shkak të mungesës së financimit nga buxheti i Kosovës për vitin 2011.

Sikur edhe u tha më lartë, ana e dytë e decentralizimit, që është më pak politike, ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve të mira në një mënyrë që u përgjigjen më mirë nevojave të banorëve lokal sesa atëherë kur

ato janë ofruar nga qeveria qendrore. Ky është decentralizimi i vërtetë, ku përfitimet shihen dhe ndjehen drejtpërdrejt nga qytetarët – një lloj i decentralizimit që në fund të fundit përcakton nëse procesi ka qenë i suksesshëm apo vetëm një kompromis politik për pavarësi. Ofrimi i shërbimeve, në vende të caktuara, ka pasur progres por akoma mbetet i dobët. Financat komunale, edhe pse në rritje, vazhdojnë të kufizojnë përmirësimet në ofrimin e një numri të shërbimeve. Bartja e fondeve tek komunitet, rreth 25% e buxhetit të përgjithshëm (vetëm 7.7% të granteve specifike) nuk mjaftojnë për të mbajtur kualitetin aktual të shërbimeve – e lëre më që këto shërbime të bëhen më kualitative dhe më të qasshme. Për më tepër, kapacitetet e kufizuara të personelit për të ofruar shërbime në mënyrë profesionale, të shoqëruara me menaxhim jo-efikas të pasurive dhe kontradiktat në mes të akteve ligjore në sektorë të ndryshëm të shërbimeve, janë pengesa tjera për komunitet në ofrimin e shërbimeve. Megjithatë, ka po ashtu argumente që komunitet nuk janë duke u mbështetur në mekanizma të dëshmuar për t'i bërë shërbimet më efikase, siç janë marrëveshjet e bashkëpunimit ndër-komunal, si dhe gjenerimi i të hyrave më të mëdha vetanake për të mbajtur dhe përmirësuar shërbimet lokale.

Menaxhimi komunal i ndërmarrjeve të reja publike, përgjegjëse për shërbimet publike, nuk ka shkuar lehtë – çështje kjo që diskutohet më në shumë detaje në vijim të tekstit. Për më tepër, sa i përket kapitalit kombëtar, qeveria qendrore ka qenë një pengesë për avancimin e një sistemi të decentralizuar të qeverisjes ashtu siç është paraparë me Kushtetutë, përderisa ligji për Prishtinën dhe fondet që vijnë me të janë mbajtur peng, duke qarur kështu në kufizime të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve.

Ka po ashtu konfuzion sa i përket kompetencave lokale, sidomos aty ku përfundon autoriteti i qeverisë qendrore dhe fillon ai i saj lokale. Në disa raste, agjencitë e qeverisë qendrore kanë hartuar norma që e kufizojnë mundësinë e komunave për të ushtruar në mënyrë efikase detyrat e tyre. Siç edhe është thënë në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2010 “Interpretimet kundërthënëse të legjislacionit mbi vetëqeverisjen, shumë shpesh e bllokojnë bashkëpunimin në mes të autoriteteve lokale dhe qendrore”. Vitin e kaluar janë paraqitur shumë mosmarrëveshje në mes të mekanizmave të komunave dhe qeverisë qendrore sa i përket autoriteteve të tyre përkatëse mbi tokat publike dhe ndërmarrjet publike, një pikë që do të trajtohet më poshtë. Krahas këtyre që u përmenden më lartë, akoma ka kompetenca që nuk janë bartur plotësisht tek qeveritë lokale, veçanërisht kompetencat e zgjeruara dhe të deleguara, siç janë pyjet, të përcaktuara me kornizë ligjore. Është e domosdoshme që këto probleme zgjidhen paralelisht me anën territoriale, më politike, të decentralizimit.

Tri vite pas zbatimit të procesit të decentralizimit, është bërë e qartë që ligjet themelore të qeverisjes lokale duhet të amandamentohen në mënyrë që t'u shërbejnë komunave. Faktet nga ky studim tregojnë se ligji më themelor nga të gjithë, ai për Vetëqeverisje Lokale, është duke u sfiduar skajshmërisht nga ligjet sektoriale. Përderisa vitin e kaluar studimi jonë tregoj që decentralizimi ishte i qartë në letër por i turbullt në praktikë, studimi jonë këtë vit konstaton se madje legjislacioni edhe në letër është duke u bërë i paqartë, përderisa në praktikë është duke qarur në konfuzion dhe shkelje të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Përderisa vala fillestare e decentralizimit ka qenë një iniciativë nga lartë-poshtë, që ka ardhur nga negociatat dhe Pakoja e Ahtisaarit, kërkesat për decentralizim tani janë duke ardhur nga poshtë-lartë, me gjashtë (6) lokacione të reja që i kanë dërguar kërkesat për të marrë statusin e komunës¹. Këto

¹KohaDitore. 14 prill 2011. Dëshirojnë të bëhen komuna. F. 13.

lokalitete kanë parë përfitimet që mund të sjell decentralizimi në aspekt të resurseve; sidoqoftë, ato po ashtu dëshirojnë që shërbimet të jenë më afër tyre. Ky proces duhet të përkrahet në të ardhmen, por me kritere të qarta të cilat nuk janë të motivuara politikisht. Ofrimi i shërbimeve duhet të jetë baza për krijimin e komunave të reja pasi që ky është parimi kryesor i decentralizimit e jo komunat etnike, të cilat duhet të mënjnohen pasi që ato kontribuojnë më shumë në ndarje sesa në integrim të shoqërive.

Decentralizimi i Komunave të Reja

Hyrje

Procesi i decentralizimit ka sjellë rezultate përmes komunave të reja në përputhje me Marrëveshjen e Ahtisaarit të përpiluar në bazë të negociatave në Vjenë, mirëpo këto arritje nuk do të jenë të kompletuara përderisa komuna e Mitrovicës veriore ende nuk është themeluar si komunë legjitime nën mbikëqyrjen e autoriteteve të Kosovës. Kjo vazhdon të jetë një problem serioz në aspektin e sundimit të krimit dhe kontrabandës që ka rezultuar në këtë pjesë si dhe mungesës së qeverisjes lokale që punon për banorët lokal. Ndarjet etnike atje ende janë të forta.

Përderisa komunat tjera të themeluara kohëve të fundit janë konsoliduar dhe po marrin kompetencat e garantuara me kushtetutë, disa sfida të vjetra ende qëndrojnë. Institucionet paralele ilegale ende funksionojnë duke e sfiduar autonominë e plotë të pushtetit lokal legjitim. Në fushën e arsimit, autoritetet e Kosovës e kanë të pamundur të aplikojnë plan-programin e Kosovës por as që mund të bëjnë ndonjë bashkëpunim në mes të shkollave të Graçanicës dhe të autoriteteve Kosovare pasi që mësuesit paguhën nga Beogradi dhe janë nën direktivat e tij.

Ofrimi i shërbimeve në fushat tjera është ende i dobët, pjesërisht për shkak të financave lokale. Këto financa edhe pse janë përmirësuar vazhdojnë të jenë pengesë e përmirësimeve të domosdoshme të shërbimeve lokale. Po ashtu menaxhimi me shërbime themelore përmes ndërmarrjeve publike nuk ka shkuar shumë lehtë. Disa komuna nuk kanë mundur apo nuk kanë pasur vullnet në emërimin e anëtarëve të bordit në Ndërmarrje Publike Rajonale (NPR). Edhe më tutje kompetencat e zgjeruara që garantohen me legjislacion për disa komuna nuk janë marrë përsipër për disa arsye.

	Sipërfaqja (km ²)	Banorë	Serbë (%)	Dalja në votime (2009)	Dalja në votime (2010)
Graçanica	131.25	18,642	85,7%	23%	45.09%
Novobërda	203.96	11,382	60%	25.5%	50.32%
Ranillugu	74,28	4,955	95%	12.4%	34.31%
Klllokoti	23.39	4,542	72%	25.2%	46.79%
Parteshi ²	28, 66	5,217		55, 94%	51.62%

² Zgjedhjet komunale për themelimin e komunës së Parteshit janë mbajtur me 20 qershor, 2010.

Mitrovica e Veriut	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
--------------------	-----	-----	-----	-----	-----

Edhe me gjithë përkrahjen dhe monitorimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të përforcuar me mekanizmat ndërkombëtar, komunat e reja nuk kanë mundur të mënjanojnë marrjen e vendimeve që kanë rënë ndesh me ligjet kornizë, gjë që tregon se edhe administrata e këtyre komunave nuk është kursyer nga çështjet politike të ndjeshme. Vendimi i Komunës së Ranillugut për të japë si donacion pronën për ndërtimin e kishës ortodokse apo miratimi i logos nga Komuna e Graçanicës që përfaqëson vetëm njërin komunitet tregon dhe moskuptimin e plotë të legjislacionit nga komunat e reja. Po ashtu, pushimi nga puna i drejtorit të administratës dhe Zëvendës Kryetarit të Komunës së Klllokotit, ka treguar ndërhyrje politike në administratën komunale të kësaj komune. Institucionet qendrore, sidomos MAPL, duhet të jenë më aktive në vetëdijesimin e komunave të reja për kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre sidomos në kompetencat që shpërndahen në nivele të ndryshme të pushtetit.

Progresi në Komunën e Graçanicës

Komuna më e përparuar nga komunat reja, Graçanica, ka lëvizur drejt ndërtimit të kapaciteteve të veta administrative dhe financiare; mirëpo, disa nga problemet e vjetra, si konkurrenca nga institucionet paralele të qeverisë së Serbisë ende ekzistojnë. Në anën tjetër, sfida të reja kanë lindur me shtimin e kompetencave dhe përgjegjësi në këtë komunë. Sistemi i arsimit dhe sistemi shëndetësor qëndrojnë jashtë kontrollit të plotë të komunës apo të institucioneve qendrore të Kosovës. Shkollat operojnë nga punëtorë dhe mësues të paguar nga qeveria e Serbisë dhe refuzojnë bashkëpunimin me autoritetet legjitime duke përdorur plan-programe që nuk janë aprovuar nga qeveria e Kosovës. Situata në sistemin e shëndetësisë është mjaft e ngjashme. Deri më sot komuna nuk ka mund të ushtroj kompetencën e saj të garantuar në menaxhimin e shëndetit sekondar në komunë. Kjo është pjesërisht shkak i mungesës së përpjekjeve të mjaftueshme të qeverisë qendrore dhe pjesërisht shkak i situatës politike në terren.

Kryetari i Graçanicës, Bojan Stojanović, ka qenë këmbëngulës në theksimin e rëndësisë për serbët e Kosovës që të jenë pjesëmarrës si pala e tretë në dialogun Kosovë – Serbi, pasi që tash dihen mirë sfidat reale në këto komuna. Ai po ashtu i ka bërë thirrje Beogradit të bisedoj me popullatën serbe në komunat e reja të Kosovës që të binden të jenë pjesë e procesit³.

Komuna e Graçanicës është komuna më e madhe dhe më e suksesshme deri më tani gjerë nga fillimi i procesit të decentralizimit. Duket që së shpejti do të bëhet dhe qendra më e madhe urbane për serbët e Kosovës, veçanërisht për ata që gjenden në jug të lumit Ibër. Graçanica po ashtu është komuna kryesore ku bizneset lokale – sidomos të sektorit të ndërtimit – kanë shprehur interes në zgjerimin e bizneseve të tyre. Kjo ka mundësuar këtë komunë të gjeneroj të hyra vetanake më të mëdha dhe kështu ka filluar dhe implementuar projekte që kanë përfutur qytetarët e saj.

Si komunë e themeluar në gusht të vitit 2009, administrata aktualisht është e përbërë nga shtatë (7) drejtori ekzekutive. Ka përpiluar dhe miratuar Strategjinë Komunale 2010-2012 që definon prioritetet në të cilat do të përqendrohet komuna në kohën afat-shkurtë dhe afat-mesme. Vetëm para pak kohe (korrik 2010) – bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal – Graçanica ka pranuar të gjitha dokumentet e nevojshme nga “komuna amë” e Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Lipjanit, duke përfshirë këtu bartjen e arkivave, zonave kadastrale, tatimeve në pronë, shfrytëzimin e pronave, dokumentet e planifikimit hapësinor dhe urban dhe regjistrin civil⁴. Me përkrahjen e UNDP-së, MAPL gjithashtu i ka bartur komunës pajisjet për administrimin e kadastrit.

Mirëpo emblema e Graçanicës që përfshin elemente që përfaqësojnë lashtësinë e kësaj komune kanë rezultuar të jetë problematike pasi përfaqësojnë vetëm një komunitet, atë serb. Përderisa shumë akterë kanë treguar paralelet në mes të rastit të emblemës së Graçanicës dhe asaj të Prizrenit, pasi të dyja komunat janë multietnike, rasti i Graçanicës nuk është dërguar në Gjykatën Kushtetuese siç ka ndodhë me rastin e Prizrenit. I vetmi shqiptar që është anëtar i Kuvendit Komunal të Graçanicës kishte thënë se ishte kritikuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që kishte bërë zë në këtë rast kur ai kishte votuar kundër kësaj embleme.

³ Komuna e Graçanicës ueb faqe: <http://kk.rks-gov.net/gracanice/News/Kosovski-srbi-treba-da-budu-treca-strana-u-pregovo.aspx>

⁴ Blaku, S. “Tri Komuna Kompletohen me Dokumentacion” Kosova Sot, 1 Gusht, 2010, faqe 2.

Gračanica ka pranuar 766,478 euro investime kapitale vetëm nga MAPL, shumica e të cilave janë investuar në projekte infrastrukturore si ndërtimi i rrugëve, kanalizimi, ujësjellësi, ndërtimi i objekteve të sportit, ndriçimi, restaurimi i monumenteve fetare, etj. Komuna po ashtu tash ka edhe një ndërtesë të re ku operojnë administrata komunale e financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në bashkëpunim me MAPL-në.

Progresi në Ranillug

Ranillugu, një tjetër komunë që paraqitet si një sukses i decentralizimit, po përballet me sfida në rrugën e saj drejt konsolidimit. Përkundër faktit se Ranillugu ka filluar të ndjejë relativisht shpejt përfitimet e decentralizimit territorial, si dhe investimet që vijnë me të, ajo është një komunë e vogël ende në proces të konsolidimit që përballet me shumë vështirësi në menaxhimin e të gjitha kompetencave të reja dhe vështirësi në gjetjen e mbështetjes së koordinuar nga qeveria qendrore dhe organizatat ndërkombëtare. Mungesa e infrastrukturës bazë, së bashku me papunësinë e lartë, janë problemet kryesore më të cilat përballet kjo komunë. Për t'iu dal përpara këtyre sfidave si dhe për të ofruar të gjitha shërbimet që priten nga komuna me legjislacion, një injeksion i fortë i të ardhurave është i nevojshëm.

Ndërsa fondet janë rritur, pushteti lokal thekson se financat e mjaftueshme janë një sfida. Ashtu si në komunat tjera, numri i personelit është konsideruar shumë i vogël për të përballuar të gjitha përgjegjësitë e administratës komunale dhe qeverisjen lokale. Kjo komunë konsideron se shumica e fondeve të tyre shkojnë për të mbuluar pagat dhe shpenzimet, dhe shumë pak mbetet për investime nga ana e komunës. Të hyrat vetanake të komunës, si për çdo komunë të vogël dhe të re, janë të vogla - 30.582 euro në vitin 2010, prej të cilave 23.004 euro ishin të siguruar nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit, 1.680 euro nga Departamenti i Administratës dhe 5.856 euro nga Departamenti për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi⁵. Investime kapitale të qeverisë qendrore të Kosovës në komunën e Ranillugut për vitin 2010 ishin 240.151 euro, ndërsa për 2011 për investime kapitale në këtë komunë janë të parapara vetëm 92.791 euro - për punët e shtratit të lumit lokal dhe furnizimit me ujë .

Rreth dy milionë euro janë investuar gjatë vitit 2010 në këtë komunë, të përqendruara kryesisht në infrastrukturë shumë të nevojshme, siç janë rrugët, ujërat e zeza dhe furnizimin me ujë. Komuna ka të angazhuar edhe sigurimin e transportit pa pagesë për nxënësit shqiptarë që jetojnë në komunë⁶. Është e qartë se komuna ka shqetësime lidhur me caktimin e veçantë të kompetencave për përdorimin e tokës dhe zhvillimin urban, por ajo ka hyrë në një mosmarrëveshje me autoritetet qendrore në këtë fushë. Në nëntor të vitit 2010 komuna ka dhuruar tokë dhe 86 mijë euro për të ndërtuar një kishë ortodokse. Megjithatë, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka reaguar ndaj këtij vendimi duke pretenduar se toka është pjesë e ndërmarrjes në pronësi publike "Ekonomia Pyjore". AKP-ja paraqiti një ankesë në Gjykatën

⁵ Komuna e Ranillugut. Seanca e 9-të e Kuvendit Komunal të Ranillugut. <http://kk.rks-gov.net/ranillug/News/Eshte-mbajtur-seanca-e-nente-e-rregulite-e-Kuvendi.aspx>

⁶ Sabedini, Musa. 30 dhjetor 2010. Lajm. Përfitues edhe fshatrat shqiptare. Fq. 29.

e Qarkut e Kamenicës, e cila nga ana e saj morri një vendim për të ndaluar ndërtimin e kishës së re. MAPL dhe ICO-ja i kanë kërkuar komunës që të respektoj vendimin⁷.

Më pak se dy vjet që nga formimi, komuna kryesisht ka përfunduar përforcimet administrative. Gjatë vitit 2010 komuna miratoi katër rregullore dhe 36 vendime ishin marrë⁸. Komuna kishte themeluar gjashtë drejtori dhe me ndihmë të UNDP-së kishin miratuar strategjinë për 2010-2012. Gjithashtu zyra për regjistrim civil është hapur nga Ministria e Punëve të Brendshme. Komuna tashmë ka filluar t'i lëshoj certifikatat e lindjes, vdekjes dhe martesës sikurse edhe dokumentet tjerë që janë nën autoritetin e komunës. Përveç kësaj është hapur Zyra për Kadastër, si dhe Zyra për Komunitete që merret me çështjet e pakicave kombëtare, në këtë rast me komunitetin shqiptar⁹.

Ministria për Administrimin të Pushtetit Lokal ka monitoruar performancën e Ranillugut në tetë fusha. Bazuar në këto të dhëna, komuna ka arritur të bëjë progres në të gjitha fushat, megjithëse në nivele të ndryshueshme. Në veçanti kishte qenë një progres i matshëm në fushën e shërbimeve administrative, si dhe në infrastrukturën rrugore-në këtë fushë kishte përmirësim për 10% nga viti 2009. Po ashtu kishte një rritje për 1% në numrin e aplikimeve për lejet e ndërtimit. Megjithatë për sa i përket rishikimit për aplikim të lejeve brenda afatit të fundit ligjor, Ranillugu deri më tash ka pasur vështirësi për tu përmirësuar- ashtu siç janë edhe shumica e komunave.

Legjitimiteti i komunës së re tek komuniteti vazhdon të mbetet ende një sfidë - pavarësisht nga një shtim i mbështetjes publike kohëve të fundit. Institucionet paralele janë ende të pranishme dhe një pjesë e mësuesve dhe punëtorëve të kujdesit shëndetësor vazhdojnë të paguhen me paga të mira nga Republika e Serbisë të cilët raportohet se ofrojnë shërbime të mira në arsim dhe shëndetësi¹⁰. Ndërsa në zgjedhjet komunale të vitit 2009 pjesëmarrja në zgjedhje ishte e vogël, 12,4%, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010 pjesëmarrja është rritur në 34,12%, që tregon se qytetarët e Ranillugut kanë filluar të besojnë më shumë në institucionet e Kosovës. Por, 34% për një komunë të vogël si Ranillugu është ende një dalje e ulët, dhe kjo jep edhe një argument për rëndësinë e përmirësimit të shërbimeve komunale dhe përmirësimin e jetës ekonomike në komunë, si përcaktues për rritjen e legjitimitetit të komunës.

Komuna ende nuk po ushtron përgjegjësinë e plotë të saj në ofrimin e shërbimeve publike, pasi ajo nuk po merr pjesë në menaxhimin e ndërmarrjeve publike rajonale që i shërbejnë komunës. Gjithashtu është

⁷ Koha Ditore. 27 nëntor 2010. Kisha Ortodokse Serbe në Ranillug. fq. 14.

⁸ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. 2011. Raporti i progresit për themelimin dhe zhvillimin e komunave të reja. Fq. 12

⁹ Koha Net. 05 janar. Komuna e Ranillugut shënoi një vjetorin e themelimit.

<http://www.koha.net/index.php?cid=1,8,45587>

¹⁰ ICG. 12 maj 2009. Integrimi i Serbëve në Kosovë. Raport Europe Nr. 200

alarmante fakti se ka pasur një rritje prej vetëm 4% të popullsisë të lidhur në sistemin e furnizimit me ujë dhe kjo tregon në mënyrë të konsiderueshme progres më të ngadaltë se sa komunat e tjera¹¹.

Progresi në Komunën e Kllokotit

Procesi i decentralizimit në Kllokot ka qenë më sfiduesi në vend, kryesisht për shkak të rezistencës së popullatës së Vitisë kundrejt krijimit të komunës së re. Sidoqoftë, situata ka filluar të ndryshoj dhe Kuvendi Komunal i Vitisë ka filluar të ndihmojë Kllokotin në ushtrimin e kompetencave të reja duke e ndarë përvojën mbi funksionimin e komunës. Në janar të viti 2010, Kllokoti ka krijuar Kuvendin e vetë Komunal dhe qeverinë lokale me pesë (5) drejtori.¹²

Problemet kryesore më të cilat ballafaqohen komunitetet janë papunësia e lartë, sidomos në mesin e të rinjve dhe mungesa e objekteve shëndetësore në afërsi. Sidoqoftë, komuna është duke pranuar fonde të shumta si nga autoritetet qendrore të Kosovës po ashtu edhe nga komuniteti ndërkombëtar. Sipas kryetarit të komunës së Kllokotit, deri në vitin 2011, 90% e infrastrukturës së fshatrave të kësaj komune është përfunduar. Gjatë vitit 2010 Kllokoti ka marrë rreth një (1) milion euro, shumica e të cilave është investuar në projektet e infrastrukturës nga Qeveria e Kosovës, përderisa MAPL i ka investuar edhe rreth 230.000 euro tjera¹³. Në përgjithësi, Kllokoti ka qenë njëra nga komunat me më së shumti fonde gjatë vitit 2010 me rreth tre (3) milionë euro në total¹⁴. Vetëm gjatë vitit 2010, rreth 100 njerëz janë punësuar, përderisa 700 janë të punësuar në tri fabrikat funksionale atje¹⁵. Komuna e Kllokotit ka një potencial të madh për turizëm, veçanërisht rehabilitimin fizik, duke pasur banjën më të mirë në rajon; prandaj, komuna duhet të bëjë më shumë përpjekje në promovimin e turizmit në rajonin e vetë në bashkëpunim me qeverinë qendrore dhe komunat fqinje.

Kuvendi Komunal i Kllokotit ka miratuar një iniciativë të Kryetarit Sasha Mirkoviq për të vendosur një taksë turistike për të gjithë turistët që vijnë dhe vizitojnë banjat në komunë. Kjo taksë 0.30 centë për pacientë do të shërbejë për të përmirësuar infrastrukturën turistike sikurse edhe për investime tjera kapitale me prioritet për komunën¹⁶.

Kllokoti me 5,145 banorë, ka një administratë relativisht funksionale edhe pse janë bërë disa ndryshime në qeverinë lokale pasi që kryetari e ka shkarkuar zëvendësin e tij, Zoran Bogdanoviq, duke e akuzuar

¹¹ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. 2011. Raporti i progresit për themelimin dhe zhvillimin e komunave të reja. Fq. 12

¹² Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. 2011. Raport Progresi në Themelimin dhe Zhvillimin e Komunave të Reja, shkurt 2011, f. 17. < http://mapl.rks-gov.net/repository/docs/shqip_raporti.pdf.pdf >

¹³ Koha Ditore, 10 janar 2011, f. 14

¹⁴ <http://kk.rks-gov.net/kllokoti/News/3-milion-investime-ne-vitin-2010-ne-komunen-e-re-t.aspx>

¹⁵ <http://kk.rks-gov.net/kllokoti/News/Zbutja-e-papunesise-sfide-per-komunen-e-re-te-Kllo.aspx>, qasur me 21 prill 2011

¹⁶ <http://www.google.com/search?sourceid=navclient&ie=UTF-8&q=Touristic++tax>, qasur me 21 prill 2011

atë për performancë të dobët dhe mungesë të seriozitetit në përmbushjen e përgjegjësisë së tij. Ky ka qenë shkarkimi i dytë i bërë nga Kryetari, pasi që më herët ai pat shkarkuar edhe Drejtorin e Drejtorisë për Administratë¹⁷.

Komuna ka bërë progres të rëndësishëm në shërbimet administrative; duke e rritur stafin nga 10 sa kishin qenë në fillim në 35 sa janë aktualisht, komuna tani konsiderohet si plotësisht funksionale¹⁸. Në pesë muajt e krijimit, Klllokoti ka arritur që të mbledhë 15.000 euro të hyra vetanake, e barabartë me 40% të taksave komunale të planifikuara që të mblidhen brenda viti.

Në prill të vitit 2011, Kuvendi Komunal i Klllokoti ka aprovuar Strategjinë për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Integrim 2011 -2014,¹⁹ duke përcaktuar bazat për zhvillim të iniciativave zhvillimore në të ardhmen për komunën në fushat e: Ekonomisë, Arsimit, Punësimit, Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, etj. Klllokoti është e para komunë që ka një strategji të tillë afatgjatë.

Progresi në Komunën e Parteshit

Parteshi ka qenë komuna e katërt që është themeluar përmes procesit të decentralizimit, më vonë sesa komunat e tjera, pasi që zgjedhjet lokale të vitit 2009 nuk mund të mbaheshin atje për shkak të rezistencës së komunitetit lokal serb. Fatmirësisht, zgjedhjet u mbajtën me 30 qershor të vitit 2010 dhe Kuvendi Komunal dhe qeveria lokale u themeluan në gusht të vitit 2010. Gjatë vitit 2010, komuna ka aprovuar një (1) Rregullore dhe një (1) vendim). Qeveria lokale funksionon me gjashtë (6) drejtori.

Sipas një njoftimi zyrtar të marsit të vitit 2011, qytetarët e Parteshit së shpejti do marrin shërbimet e tyre kadastrale në komunën e tyre të re. Zyrtarët nga Drejtoria për Kadastër e Gjilanit kanë thënë që i kanë dorëzuar të gjitha materialet kadastrale tek Drejtoria për Kadastër e Parteshit përfshirë edhe zonat kadastrale të Parteshit, Pasjanit dhe Budrigës që mbulojnë 2.865 hektarë tokë, prej të cilave vetëm 482 hektarë janë pronë publike. Kryetari i Parteshit ka shkuar një hap para kryetarëve të komunave tjera të reja duke larguar nga listat e pagave të mësuesve kosovarë qytetarë serbë që janë pjesë e institucioneve politike dhe arsimore të Serbisë – përfshirë edhe Dragan Petković, zëvendës i Ministrit serb për Kosovë, Goran Bogdanović. Ai ka shtuar që mësuesit serbë nga Parteshi, Pasjani dhe Budriga kanë nënshkruar kontratat e tyre të punës me Ministrinë e Arsimit të Kosovës dhe janë të gatshëm që të punojnë sipas legjislacionit të Kosovës.

Gjatë vitit 2010 Qeveria e Kosovës ka investuar një (1) milion euro në projektet e infrastrukturës, përderisa MAPL-ja ka investuar 230.000 euro për të ndërtuar sistemin e kanalizimit në Budrigë.

¹⁷Kosova.info. Kryetari i Komunës shkarkon zëvendësin e tij,

<http://kosova.info/2010/11/kryetari-i-komunes-se-klllokotit-shkarkon-zevendesin-e-tij/>, qasur me 24 prill 2011

¹⁸Kosova Sot, 15 janar 2011, f. 29

¹⁹Komuna e Klllokotit. Komuna e Klllokotit behet me strategji Zhvillimore. <http://kk.rks-gov.net/klllokoti/News/Komuna-e-Klllokotit-behet-me-strategji-zhvillimore.aspx>

Progresi në Komunën e Novobërdës (komunë e zgjeruar)

Zgjerimi territorial i Novobërdës e ka bërë të vështirë për qeverinë e saj që t'ia dalë mbanë me territorin e zgjeruar, si rezultat i shumë problemeve që ishin krijuar. Edhe pse komuna është përpjekur që të përmirësojë kushtet për zhvillim të biznesit, për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe pozitës së dobët gjeografike të komunës, investuesit e mundshëm për biznes ju kanë shmangur kësaj komune. Në anën tjetër, kjo komunë është treguar një rast i mirë qeverisjes ndër-etnike, me një kryetar nga komuniteti shqiptar, dhe nënkryetar dhe zëvendës kryesues në Kuvendin Komunal nga komuniteti serb.

Kuvendi i ri Komunal dhe dega e ekzekutivit të komunës së zgjeruar janë konstituuar në janar të vitit 2010, dhe që nga atëherë 10 drejtori janë konsoliduar. Shërbimet administrative ofrohen plotësisht nga komuna dhe ka një përparim të theksuar krahasuar me komunat tjera, në fushat e shërbimeve si mirëqenia sociale, ndërtimi i rrugëve, ndërtimi i sistemit të kanalizimit, rinia, aktivitetet kulturore dhe sportive, sikurse edhe pjesëmarrja e qytetarëve në të gjitha këto aktivitete. Sidoqoftë, komuna ka bërë pak përparim krahasuar me komunat tjera të reja në aspekt të zgjerimit të sistemi të ujit të pijes (aktualisht vetëm 20% e banorëve janë të mbuluar, shumë më pak se sa komunat tjera). Novobërda ka marrë fonde prej 1 (një) milion eurosh nga Qeveria e Kosovës për të investuar në projekte infrastrukturore për të përmirësuar kushtet në rrugë dhe kanalizim të komunës; përveç kësaj, nga MAPL-ja, komuna ka marrë 285.668 euro për të financuar ndërtimin e katër (4) rrugëve si dhe rindërtimin e një shkolle.

Novobërda ka një administratë të përbërë nga 292 punëtorë dhe ajo konsiderohet si funksionale dhe e aftë për të ofruar shërbime tek qytetarët. Kryetari i komunës, që vjen nga komuniteti shqiptar, është duke bërë përpjekje të mëdha që të përfshijë sa ma shumë serbë në qeverisjen lokale – duke emëruar zyrtarë nga komuniteti serbë në drejtori të udhëhequra nga shqiptarët, dhe emëruar shqiptarë në drejtoritë që udhëhiqen nga serbët – si një mënyrë për të krijuar komunikime dhe marrëdhënie më të mira ndërmjet dy komuniteteve.

Progresi në Mitrovicën e veriut

Procesi për themelimin e Mitrovicës së Veriut vazhdon të jetë më sfiduesi dhe i vështirë që nga fillimi i decentralizimit. Situata nuk ka ndryshuar shumë që nga raporti i vitit të kaluar. Qeveria e Kosovës me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar ka miratuar Strategjinë për Veriun që është pritur të shërbej si udhërrëfyes për themelimin e komunës. Mirëpo, disa muaj pasi strategjia ishte miratuar dhe Ekipi Përgatitor Komunal ishte krijuar, Beogradi me 30 maj kishte organizuar zgjedhjet komunale në këtë pjesë dhe kjo ishte një hap prapa në këtë proces. Pasi ekipi përgatitor kishte filluar përpjekjet e para për themelimin e komunës së re, Qeveria e Kosovës filloi "strategjinë për veriun" e cila synonte të rriste praninë e institucioneve të Kosovës në Mitrovicën e veriut dhe të integronte serbët por u pa edhe si dyfishim i përpjekjeve të MAPL-së.

Po këtë vit, Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG) propozoj “autonomi të dyfishtë” për Kosovën veriore ku Kosova dhe Serbia do të mund të ushtronin autoritetin e tyre të pjesshëm²⁰. Edhe pse ICG sjellke mjaft dëshmi se në fakt kjo pjesë po lëvizë në atë drejtim, ky propozim vetëm sa do të fuqizonte institucionet paralele atje. Procesi i themelimit të komunave të reja në Kosovë, siç është parë me komuna të themeluar më parë, ka treguar se decentralizimi në formë të paraqitur në Pakon e Ahtissarit, nëse bëhet me përkrahje të mjaftueshme dhe të qëndrueshme nga Qeveria e Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar, mund të sjell mundësi të mëdha dhe hapësirë të mjaftueshme për vetëqeverisje si dhe të përmirësojë mirëqenien e banorëve lokal edhe në Mitrovicën e veriut, nëse popullata aty e zgjedh këtë mënyrë.

Përderisa institucionet e Kosovës kanë lëvizur në themelimin e zyrave për shërbime publike në pjesën e veriore të Mitrovicës ku banojnë shqiptarët, Lagjen e Boshnjakëve, Mitrovica veriore është vendi me prezencën më të madhe të strukturave paralele nga të gjitha komunat me shumicë serbe në Kosovë. Kjo është në masë të madhe për shkak se Qeveria e Kosovës ka hasur në pengesa të mëdha për shtrirjen e sovranitetit dhe sistemit ligjor në atë pjesë. Pikat e kufirit me Serbinë 1 dhe 31 dihen se shfrytëzohen për kontrabandimin e mallrave, të lira nga tatimet – sidomos nafta që hyn nga Serbia përmes veriut. Ky lloj i tregtisë përkrah një elitë kriminale për të cilën Kosova dhe Serbia i kanë mbyllur sytë. Përpos kësaj Qeveria e Serbisë ka organizuar zgjedhje lokale ndërsa Kosova nuk ka mundur të organizoj zgjedhje të suksesshme në këtë pjesë në katër ciklet e fundit. Në këtë drejtim serbët e Mitrovicës së veriut nuk kanë marrë pjesë as në regjistrimin që u organizua në prill të vitit 2011 edhe përkundër përpjekjeve nga organizatat ndërkombëtare.

Edhe pse serbët e Mitrovicës janë pjesë e sistemit të drejtësisë së Serbisë, ka pasur kritika për mënyrën se si serbët e kësaj pjesë trajtohen në krahasim me serbët në Serbi. Një shembull që më së miri e ilustron këtë situatë janë kushtet e vështira të studimit dhe jetesës për studentët në universitetin që gjendet në Mitrovicën veriore. Sipas një ankete nga Banka Botërore me studentë të këtij universiteti, kur u pyeten se “Si të përmirësohet jeta studentore në qytet,” studentët në masë të madhe dhanë përgjigje zhgënjimi për kushtet ekzistuese duke theksuar mungesën e hapësirës dhe pajisjeve teknologjike dhe mungesën e akomodimit dhe ushqimit me shpenzimet e larta. Kjo anketë tregon se 80% e studentëve nuk kanë dëgjuar kurrë për mundësi të bursave për studime jashtë si dhe gjithë studentët potencuan kushtet më të këqija e mësimi për dallim me studentët në Serbi.

Slobodan Petroviq, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, një muaj pas marrjes së detyrës ishte shprehur se përkundër ndërhyrjeve të Beogradit që synojnë manipulimin e qytetarëve serbë në Kosovë dhe protestave të serbëve lokal kundër integritetit në institucionet e Kosovës, me përkrahjen vendore dhe ndërkombëtare do të bëjë progres të dukshëm në rikthimin e doganave dhe do të angazhohet në normalizimin e situatës në atë pjesë të Kosovës. Ai po ashtu premtoi se së shpejti Komuna e Mitrovicës së Veriut do të funksionalizohet por nuk dëshironte të caktonte një kohë të saktë se kur do të ndodhë kjo²¹.

²⁰ ICG. 14 mars 2011. “Veriu i Kosovës: Sovraniteti i dyfishtë në praktikë” Europe Report No. 211.

²¹ Kosova Sot. 27 Mars 2011. fq. 3

Zyrtarët e lartë serbë në Kosovë vazhdimisht kanë thënë se do të fillojnë komunikimin me përfaqësuesit e strukturave paralele sepse janë duke manipuluar me qytetarët serbë dhe po dëmtojnë procesin e integritetit të komunitetit serb në Kosovë që ka filluar²². Përpos vështirësive, MAPL ka investuar në Mitrovicën veriore diku rreth 86,000 euro përderisa Qeveria e Kosovës ka investuar vetëm në vitin 2010 dikur rreth 5 milionë euro në investime kapitale në komunat e veriut në përgjithësi.

	Investime Kapitale gjatë vitit 2010 (MAPL)*	Grantet nga Qeveria Qendrore Buxheti - 2011	Të hyrat vetanake 2011	Investime Kapitale (2011)
Gracaniça	766,478	4,138,780	400,00	1,486,688
Novobërdo	285,668	2,121,265	29,063	522,653
Ranillugu	230,000	957,071	40,000	92,791
Klllokoti	230,000	847,355	8,390	211,446
Parteshi	230,000	905,424	0	228,306
Mitrovica e Veriut	86,000	N/A	N/A	N/A

²² Po aty

III. Efektet e decentralizimit në ofrimin e shërbimeve lokale

Hyrje

Kualiteti i dobët i shërbimeve publike ka mbetur një nga çështjet më problematike në vitet e fundit dhe njerëzit gjithandej vendit vazhdimisht ankohen për nivelin e tyre të shërbimeve. Hulumtimi në terren përmes grupeve të fokusuar i bërë nga UNDP në fillim të këtij viti ka gjetur se kualiteti i dobët i shërbimeve publike është një nga gjashtë faktorët kryesorë për rritjen e pakënaqësisë në mesin e qytetarëve²³. Një nga shërbimet publike problematike është edhe furnizimi me energji elektrike, por qeveritë lokale nuk mund të bëjnë edhe shumë në këtë fushë pasi që me ligj kjo nuk është në kuadër të kompetencave të tyre. Sidoqoftë, në ofrimin e shërbimeve tjera siç janë: ofrimi i ujit të pastër të pijes, qasja në kanalizim, menaxhimi i mbeturinave, ambienti i pastër, shërbimet në arsim dhe shëndetësi, sikurse edhe mundësitë ekonomike, janë qeveritë lokale të cilat mbajnë me shumë përgjegjësi në ofrimin e tyre, siç edhe është përcaktuar me kornizën ligjore mbi vetëqeverisjen lokale.

Është pikërisht dimensionimi më shumë praktik e më pak politik i decentralizimit që ka të bëjë me këtë çështje – p.sh. ofrimi i shërbimeve të mira publike, përkatësisht ofrimi i tyre në një mënyrë që i përgjigjet më shumë nevojave të banorëve lokal sesa ato që ofrohen nga qeveritë e centralizuara. Ky është decentralizimi i vërtetë ku përfitimet e prekshme shihen dhe mirëprehen nga qytetarët, dhe ky është lloji i decentralizimit që në fund të fundit do të përcaktoj nëse ky proces ishte i suksesshëm apo vetëm një kompromis politik. Zvonimir Steviq, Sekretari Shtetëror i të ashtuquajturës Ministri e Kosovës dhe Metohisë, ka thënë se “përveç infrastrukturës, komunat e decentralizuara nuk kanë diçka të re që mund t’u ofrojnë në aspekt të një ardhme më të mirë për serbët; dhe ato nuk kanë kapacitetet për të zgjidhur problemet lokale”²⁴. Janë bërë tri vite që kur është iniciuar decentralizimi. Nëse ky argument i përdorur më lartë del i vërtetë edhe më tutje, (faktet dhe shifrat aktuale flasin për një realitet tjetër), atëherë suksesi i decentralizimit do të dëmtohej seriozisht dhe qeveria serbe do të fitonte argumentin e saj të mbajtur gjatë duke kundërshtuar serbët e Kosovës për të marrë pjesë në procesin e decentralizimit. Për këtë arsye, fokusi primar në të ardhmen duhet të jetë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga qeveritë lokale. Kryetarët e komunave të reja janë në një ‘fushëbetejë’ të përhershme me shërbimet e ofruara nga strukturat paralele. Për të pasur sukses, përkrahje e fortë dhe thelbësore duhet të epet nga institucionet qendrore në Prishtinë.

Duhet pasur parasysh që decentralizimi me fokus në ofrimin e shërbimeve prekë të gjitha komunat e Kosovës, madje edhe ato komuna që nuk ka dhënë apo marrë territor. Decentralizimi për këtë qëllim do të jetë po ashtu përcaktues për shtrirjen e këtij procesi po ashtu edhe në pjesët më të ndjeshme dhe sfidues të Kosovës, pjesën veriore. Pjesa vijuese e punimit do të shqyrtojë përparimin që është bërë në: 1) ofrimin e autonomisë së domosdoshme tek institucionet lokale për të ofruar shërbime, 2) fondet e përgjithshme të ofruara për ofrim të shërbimeve dhe mjetet vetanake që komunat kanë mundur të

²³ Raporti i Pulsit Publik. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Prishtinë, f. 51.


²⁴ Radio KiM. Kontradikta në lidhje me komunat e decentralizuara. 2 shkurt, 2011.

gjenerojnë për të ofruar shërbime publike, dhe 3) performanca e komunave dhe aktorëve tjerë në ofrimin e shërbimeve aq të nevojshme për qytetarët.

Autonomia në ofrimin e shërbimeve

Së pari, MAPL-ja dhe ICO-ja ²⁵ theksojnë që të gjitha kompetencat vetanake të parapara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale janë bartur tek qeveritë lokale (përfshirë këtu komunat në veri të Kosovës)²⁶. Kompetencat e deleguara janë në proces të bartjes tek qeveritë komunale, përderisa kompetencat e zgjeruara, të parapara për komunat me shumicë serbe, nuk janë bartur. Sidoqoftë, që një komunë të jetë në gjendje për të ofruar shërbime të mira ajo duhet të ketë autonomi të konsiderueshme për të vepruar në atë fushë dhe në të njëjtën kohë institucionet e qeverisë qendrore duhet të jenë në gjendje që të ofrojnë asistencë teknike, përkrahin dhe mbikëqyrin që ligjet nuk janë duke u shkelur.

Madje edhe në fushat siç është zhvillimi ekonomik, komunat duhet të kenë më shumë autonomi për të vendosur për të ardhmen e tyre zhvillimore, përderisa institucionet qendrore e ndihmojnë dhe koordinojnë këtë zhvillim. Zhvillimi ekonomik lokal është theksuar si kompetenca e parë për të bartur tek komunat, megjithatë se çka përnjëmend duhet të bartet nuk është hulumtuar shumë ²⁷. Anketa e fundit e Pulsit Publik ka treguar që vetëm 5,7% e njerëzve besojnë se qeveritë lokale janë përgjegjëse për zhvillimin ekonomik në Kosovë²⁸. Në mesin e serbëve të Kosovës kjo nuk ndryshon shumë pasi që niveli i besimit është vetëm në 6,8%. Kjo tregon që komunat nuk kanë qenë në gjendje të demonstrojnë kapacitetet e tyre për të ndërmarrë iniciativë të zhvillimit ekonomik në komunat e tyre – për të dëshmuar që qytetarët mund të mbështetën në qeverinë e tyre lokale për të përmirësuar standardin e tyre jetësor. Kjo është veçanërisht e vërtetë për komunat e banuara me serbë, ku zyrtarët lokal duhet të tregojnë sukses në përmirësimin e kualitetit të jetës dhe ekonomisë në mënyrë që fitojnë besimin e qytetarëve të tyre.



²⁵Faqja elektronike e ICO-së. Zbatimi i Pakos Gjithëpërfshirëse të Ahtisaarit – Gjendja e implementimit.

²⁶Intervistë me Avni Sahiti, Drejtor i departamentit për Hulumtim dhe reformë të qeverisjes lokale. 29 mars, 2011.

²⁷Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040), http://www.assemblykosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_en.pdf, qasur me 15 mars, 2011.

²⁸Raporti i Pulsit Publik. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Prishtinë, f. 51.

Përdorimi i tokës është një nga kompetencat tjera të përmendura në ligjin për vetëqeverisje lokale e që duhet bartur tek komunat. Sipas autoriteteve qendrore kjo kompetencë është tani në duart e komunave. Në fakt, komunat kanë pasur vështirësi në ushtrimin e këtij autoriteti kryesisht për shkak të mungesës së autonomisë dhe përkrahjes teknike nga ana e institucioneve qendrore përkatëse. Për më tepër ka një konflikt sa i përket pronësisë së tokave publike në komuna. Qeveria qendrore përcakton të drejtat e pronësisë të tokës, dhe përmes Agjencisë Kosovare të Privatizimit privatizon shumicën e tokës publike – ku të ardhurat nga shitja shkojnë në Fondin e Privatizimit, e jo tek komunat. Në anën tjetër, komunat përballen me probleme të mungesës së tokës për zhvillim ekonomik, ndërtim të shkollave, spitaleve dhe ndërtesave të administratës për të përmirësuar shërbimet e tyre publike.

Mungesa e autonomisë dhe përkrahjes nga qeveria qendrore sjellë situata sikurse rasti i vitit të kaluar me ndërtesën e Bankosit në Gjakovë, ku aktualisht ka një mosmarrëveshje të madhe ndërmjet komunës dhe Agjencisë sa i përket pronësisë së ndërtesës. Në këtë rast, komuna e Gjakovës e morri iniciativën për përmirësimin e shërbimeve publike duke e përdorur ndërtesën e ish-Bankosit. Qytetarët e admiruan komunën për një gjë të tillë pasi që kjo mundësoi shkurtimin e rreshtave të pritjes për dokumente personale dhe eliminoj në një shkallë korrupsionin dhe nepotizmin që shfaqej në raste të ndryshme, sidomos gjatë verës kur diaspora në mënyrë të ndjeshme rritke kërkesën për shërbime nga komuna²⁹. Sidoqoftë, Agjencia e Privatizimit i ka kërkuar komunës që të heq dorë nga objekti sepse ajo i përket Agjencisë. Nëse një gjë e tillë do të ndodhte, ofrimi i shërbimeve publike do të përkeqësohej dhe ky nuk është mesazhi që qeveria qendrore duhet të dërgoj përderisa në anën tjetër është duke zhvilluar procesin e decentralizimit.

Graçanica ka një mosmarrëveshje të ngjashme për pronën e Ratarit e cila nuk dihet nëse është pronë publike apo jo³⁰. Mosmarrëveshja akoma nuk është zgjidhur. Përveç kësaj, Shtimja është duke ndërtuar një park të biznesit në një tokë ku ka mosmarrëveshje në lidhje me pronësinë. Komuna e Rahovecit ka shumë probleme me përdorimin e tokës pasi që ka mosmarrëveshje me Agjencinë e Privatizimit, si zgjidhje, komuna ka kërkuar nga qeveria qendrore që të japë më shumë autonomi tek komuna për këtë kompetencë³¹.

Edhe në rastet kur nuk ka mosmarrëveshje për pronën komunale, nëse një komunë dëshiron t'ja ndërrojë destinimin asaj, qoftë për zhvillim ekonomik apo shërbime publike, ajo duhet të marrë leje nga tri komuna të ndryshme nëse ndryshimi është për një periudhë më të gjatë se 10 vite, thotë Hysen Jerliu nga komuna e Kamenicës, duke e cituar ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës³². Në rastet e ndryshimit për më pak se 10 vite, komuna nuk ka nevojë për leje nga qeveria qendrore. Sidoqoftë për investorët privat, stimulimet për shfrytëzim të tokës për afat më të gjatë janë vendimtare. Kjo e bënë këtë të rëndësishme për komunat që mos të kufizohen në këtë kompetencë. Komunave duhet t'u lihet pronësi në një pjesë të tokës për nevojat e tyre zhvillimore të

²⁹ Më herët komuna e Gjakovës ka pasur një ndërtesë të vogël për dokumente personale në pjesën më të ngarkuar të tregut të qytetit ndërsa tani ajo është duke përdorur hapësirën e gjerë të ish-Bankosit.

³⁰ Intervistë personale me Nebojsha Milovanoviq, Drejtor i Administratës, Komuna e Graçanicës. 14 prill, 2011.

³¹ Intervistë me Perparim Krasniqi, Drejtor i Shërbimeve Publike, Komuna e Rahovecit. (përmes postës elektronike).

³² Intervistë me Hysen Jerliu, drejtor i Shërbimeve Publike, Komuna e Kamenicës (përmes emailit).

ardhshme, ose për të përmirësuar shërbimet e tyre ose të ofrojnë stimulime ekonomike për zhvillim të biznesit lokal. Për më tepër, kjo kompetencë nuk duhet të mbetet vetëm në letër. Madje edhe ICO-ja ka vlerësuar se ka mungesë të tokës për shërbimet komunale dhe se ka një nevojë për një kornizë ligjore të përmirësuar në mënyrë që të kërkohet tokë për këtë qëllim³³.

Edhe në fushën shërbimeve publike themelore, një kompetencë që dihet që kërkon një rol të fuqishëm menaxherial të qeverisjes lokale në mënyrë që të sigurohet shërbim efikas, caktimi i qartë i përgjegjësisë mbetet problematik. Në njërin anë, autoriteti i komunave për të ekzekutuar këtë kompetencë është i themeluar qartë brenda kornizës së ligjit për vetëqeverisje lokale mirëpo në anën tjetër legjislacioni sekondar nuk është në harmoni me këtë ligj. Në praktikë, sidoqoftë, operimi substancial i shumicës së këtyre shërbimeve publike kontrollohet nga ministritë përkatëse të linjës³⁴. Sipas ligjit për Ndërmarrjet Publike, nëse një ndërmarrje ofron shërbime për tri apo më shumë komuna, ajo ndërmarrje bie nën menaxhimin e qeverisë qendrore, përdërisa në anën tjetër ligji për vetëqeverisjen lokale menaxhimin e ndërmarrjeve lokale e vendos ekskluzivisht tek komunat.

Nëse një ndërmarrje publike menaxhohet nga niveli qendror, atëherë komuna nuk mundet të ushtroj pushtetin e vetë lirshëm. Hysen Jerliu, drejtor i drejtorisë për shërbime publike, thotë që – bazuar në ligjin mbi vetëqeverisjen lokale komuna është përgjegjëse për menaxhimin e furnizimit me ujë, menaxhimin e mbeturinave dhe ngrohjen publike; sidoqoftë, sipas ligjit për Ndërmarrjet Publike këto kompetenca janë në kuadër të menaxhimit të ndërmarrjeve publike. Ai shton se edhe pse komuna e Kamenicës ka bërë investime madhore në infrastrukturën ujore dhe menaxhimin e mbeturinave, ajo nuk e ka lirinë që t'i ofrojë vetë këto shërbime pasi që ato nuk menaxhohen nga komuna. Ngjashëm, këto shërbime menaxhohen nga ndërmarrjet edhe në komunën e Gjilanit, përkatësisht "Higjena" menaxhon mbeturinat ndërsa "Hidromorava" menaxhon furnizimin me ujë³⁵.

Për shkak të kësaj paqartësie, menaxhimi i mbeturinave dhe furnizimit me ujë është dëmtuar rëndë vitin e kaluar. Një ligj i ri mbi Menaxhimin e Mbeturinave dhe për Ujin priten të dërgohen për miratim në Kuvend gjatë këtij viti dhe pritet të shihet nëse se paku ligjërisht kjo paqartësi do të rregullohet.

Së dyti, ka kufizim për qeveritë lokale për të themeluar ndërmarrjet e tyre komunale nëse ato nuk janë të kënaqura me ndërmarrjet aktuale. Kuvendi Komunal i Kaçanikut në prill të vitit 2010 e bëri pikërisht një gjë të tillë duke vendosur që ta themelojnë ndërmarrjen e tyre komunale "NPK Lypoteni"³⁶. Sidoqoftë, qeveria qendrore thotë që qeveria lokale ka shkelur nenin 11 të ligjit për Ndërmarrjet Publike. Ata konsiderojnë se qeveritë komunale nuk kanë autoritetin e duhur për të marrë një iniciativë të llojit të tillë³⁷.

³³ Faqja elektronike e ICO-së. Zbatimi i Pakos Gjithëpërfshirëse të Ahtisaarit – Gjendja e implementimit.

³⁴ Hajnal, Gyorgy dhe Peter, Gabor. Reforma lokale në Kosovë. Forumi 2015. Shkurt, 2010.

³⁵ Intervistë me Hysen Jerliu, drejtor i Shërbimeve Publike, Komuna e Kamenicës (përmes emailit).

³⁶ MAPL. Raporti mbi performancën e komunave - 2010. 02 qershor, 2011.

³⁷ Neni 11.1 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike thotë "Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, çdo ndërmarrje e re publike mund të themelohet vetëm nëse autorizohet me një vendim të qeverisë".

Së treti, qeveria qendrore ndërhyt në autonominë e qeverive qendrore për të ofruar shërbime publike duke dominuar inspektimet teknike dhe mos lejuar secilën komunë që të vendos taksat e veta për ato shërbime. Disa komuna mund të vendosin që rritja e taksës për një shërbim që ata e ofrojnë mund të jetë diçka që qytetarët e tyre mund të paguajnë në mënyrë që të rriten të hyrat për të përmirësuar këto shërbime. Në komuna të tjera, autoritetet lokale mund të vendosin që taksat të ulen ose të mbesin të njëjta pasi që ofrimi i shërbimeve nuk është edhe aq i vështirë. Në cilindo rast, nëse një kompetencë e tillë i është dhënë komunave me ligj dhe qeveria qendrore dëshiron që përmirësoj ofrimin e shërbimeve, zgjedhjet e tilla mund të lihen tek qeveria lokale me mbikëqyrje të kufizuar dhe asistencë teknike në planifikimin e qeverisë lokale.

Në rastin e arsimit publik dhe kujdesit shëndetësor, edhe pse këto shërbime janë bartur tek qeveritë lokale (edhe me legjislacion sekondar), komunat kanë pak ndikim mbi buxhetimin, planifikimin e investimeve kapitale dhe përdorimin e fondeve. Këto tipare esenciale akoma me të madhe i besohen Ministrisë së Arsimit dhe respektivisht asaj të Shëndetësisë. Për shembull, përderisa autoritetet lokale janë të ngarkuara me shpërndarjen e pagave për mësuesit dhe punonjësit shëndetësor, ata duhet që në mënyrë strikte t'i përmbahen listës që u ofrohet nga dy ministritë qendrore. Kohëve të fundit ka pasur përparim sa i përket autonomisë komunale financiare në arsim por kjo është duke lëvizur shumë ngadalë dhe është duke ndodhur vetëm në disa komuna.

Mbrojtja e pyjeve është ndoshta shembulli më i mirë se si një kompetencë legalisht e dhënë tek qeveritë lokale akoma është larg bartjes në praktikë. Përderisa e definuar qartë si një kompetencë e deleguar me kornizën e legjislacionit, në praktikë shumë pak pushtet bie mbi qeverinë lokale, duke e lënë atë tek Agjencia për Mbrojtjen e Pyjeve, një Agjenci e krijuar nga dhe e mbikëqyrtur nga qeveria qendrore. Kjo praktikë ka qenë shkatërrimtare për mbrojtjen e pyjeve, pasi që Agjencia në fjalë nuk është e pajisur mirë për të kryer punë. Si rezultat, në shumë raste qeveritë lokale kanë parë shkatërrimin e pyjeve të tyre dhe nuk kanë pasur autoritetin praktik për të bërë diçka për të parandaluar atë. Pas shumë aktiviteteve avokimi nga komunat, një Ligj i ri për Pyjet pritet që të dërgohet në Kuvendin e Kosovës; draft ligji i propozuar ka paraparë shuarjen e Agjencisë për Mbrojtjen e Pyjeve dhe do të jap autoritetin e plotë tek qeveritë lokale.

Kompetenca (lloji)	Statusi i raportuar një vit më parë	Niveli aktual i autonomisë
Përdorimi i tokës dhe zhvillimi	Të bartura	- Nuk ka autonomi në menaxhimin e tokës publike dhe pronave brenda komunave. - Të drejtat e pronësisë të përcaktuara nga niveli qendror. - Agjencia për Privatizim ka privatizuar shumicën e tokës publike në komuna - Ka shumë mosmarrëveshje ndërmjet komunave

		dhe Agjencisë së Privatizimit. - Për të dhënë me qira tokën për më shumë 10 vite, nevojitet leja nga tri ministri. - Komunitat janë lënë me shumë pak tokë për zhvillim lokal apo shërbime komunale.
Shërbimet komunale (kompetencë vetanake ³⁸)	Jo të bartura plotësisht ose funksionale plotësisht. Legalisht ato janë të bartura tek komunitat apo një grup i komunitave por ato akoma nuk janë operacionalizuar plotësisht pasi që komunitat nuk po mundën të emërojnë anëtarët e bordeve në ndërmarrjet publike. Menaxhimi i ujit nuk është bartur.	- Ministritë e linjës shumë të forta në menaxhimin e shërbimeve publike. - Ministritë e linjës i vendosin ndryshimet për shërbimet dhe e dominojnë procesin e inspektimeve. - Komunitat nuk lejohen që të themelojnë ndërmarrjet e tyre për shërbime publike. - Qeveria qendrore dhe AKP-ja menaxhojnë me një korporatë për shërbime publike për shërbime publike nëse ajo mbulon tri apo më shumë komuna. - Investim kapital i pamjaftueshëm për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe menaxhimin e tij; pak stimulim për komunitat për të kontribuar në investimet me dispozitat aktuale institucionale.
Arsimi publik (kompetencë vetanake)	Listat e pagave për mësuesit janë bartur tek qeveritë lokale, sikurse edhe emërimi i drejtorëve të shkollave. Ligji mbi arsimin në komuna (03/L-068) është miratuar	- Ndikim i madh në buxhetim, planifikim të investimeve kapitale dhe përdorim të fondeve nga ana e MASHT-it.
Mirëqenia sociale	Të bartura, por mbesin vështirësi në menaxhimin e	-

³⁸Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale i parasheh tri lloje të kompetencave: kompetencat vetanake, me autoritet të plotë të dhënë tek komunitat, kompetencat e deleguara, ku autoriteti mbetet tek institucionet qendrore por qeveritë lokale delegohen për të ofruar shërbime, dhe kompetencat e zgjeruara që janë kompetenca të zgjeruara vetëm për disa komuna me shumicë serbe.

	shërbimeve sociale. Ka nevojë për trajnim. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka qenë e ngadaltë në bartjen e kësaj kompetence tek qeveritë lokale edhe pse ka qenë një punë e vështirë pasi që është dashur që të merren me 30 qendra lokale të shërbimit social	
Kujdesi i shëndetit publik	Bartur. Listat e pagave të punonjësve shëndetësor janë në duart e qeverive lokale. Sidoqoftë, lista e barnave esenciale që po ashtu është pjesë e kësaj kompetence, akoma nuk është bartur.	- Ndikim i fortë mbi buxhetim, planifikim të investimeve kapitale dhe përdorim të fondeve nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.
Kujdesi shëndetësor sekondar (kompetencë e zgjeruar)	Ligji për Kujdesin Shëndetësor Lokal të reflektoj kompetencat e zgjeruara të kujdesit shëndetësor sekondar (ICO)	- Nuk është bartur, kjo temë është akoma në listën për dialog në mesin e aktorëve kryesorë ³⁹ . - Kushtet administrative dhe fiskale për funksionet e zgjeruara në komunitetet serbe duhet të garantohen. Një gjë e tillë do të kërkojë rregullime specifike nga ministrinë e linjës dhe fonde shtesë nga buxheti i Kosovës ⁴⁰
Shpërndarja e pagesave të asistencës sociale (kompetencë e	Nuk është bartur	

³⁹ Intervistë me Nebojsa Milovanović, Drejtor i Administratës, Komuna e Graçanicës, 14 prill 2011.

⁴⁰ Hajnal, Gyorgy dhe Peteri, Gabor. Reforma Lokale në Kosovë. Forumi 2015. Shkurt, 2010.

deleguar)		
Mbrojtja e pyjeve (kompetencë e deleguar)	Nuk është bartur. Agjencia për Mbrojtjen e Pyjeve, një institucion i krijuar nga Kuvendi akoma e mbikëqyrë mbrojtjen e pyjeve.	- Memorandumi i Mirëkuptimit i nënshkruar ndërmjet komunave, MAPL-së dhe Ministrisë së Bujqësisë për të bartur kompetencat për “mbrojtjen e pyjeve dhe dhënien e lejeve për prerje të pyjeve”.

Financimi për ofrim të shërbimeve

Përderisa në shumë raste komunat janë të kufizuara në ushtrimin e kompetencave të dhëna nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, kufizimi kryesor, siç do të thoshte çdo kryetar komune, ka të bëjë me fondet që nevojiten për të përmbushur në mënyrë efikase të gjitha përgjegjësitë e marra kohëve të fundit. Me rritjen modeste të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës, fondet për komunat janë rritur në mënyrë që t’u dilet mbanë sfidave të kompetencave të reja. Megjithatë, rritja proporcionale është e vogël. Vitin e kaluar, qeveria qendrore rriti buxhetin për të gjitha 36 komunat për më pak se 30 milionë euro. Sidoqoftë, në vitin 2010, edhe pse shifrat tregojnë një rritje të buxhetit për komunat për 60 milionë euro, pjesa komunale e buxhetit të përgjithshëm ka rënë për 0,4%. Madje edhe grantet për qeveritë lokale kanë rënë pak në proporcion me buxhetin e përgjithshëm. Në një kohë kur decentralizimi dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike është prioritet i qeverisë, rritja e buxhetit për komunat duhet të jetë i barabartë ose më i madh sesa proporcioni i buxhetit të përgjithshëm.

Por a është kjo rritje e fondeve e mjaftueshme për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve po aq as është e nevojshme që të përmirësohet perceptimi i qytetarëve në ofrimin e shërbimeve lokale? Graçanica kryesisht llogarit në financat e veta për të përmirësuar shërbimet dhe nuk është e kënaqur me fondet për vitin 2010 dhe 2011 për këto shërbime, thotë Nebojsha Periq, këshilltar i Kryetarit⁴¹. Drejtori i Shërbimeve Publike të Rahovecit thekson që komuna nuk ka resurset e mjaftueshme për të ofruar shërbime të mira për të gjithë qytetarët; arsyeja kryesore është buxheti i vogël për komunën – pasi që për dy vitet e fundit nuk ka pasur rritje të buxhetit komunal, përderisa kërkesat e qytetarëve janë rritur⁴². Duke qenë në nevojë të madhe për fonde shtesë, kjo komunë ka dërguar 21 propozime të Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për projekt të shërbimeve

⁴¹Intervistë me Nebojsha Periq, këshilltar i Kryetarit të Graçanicës.

⁴²Intervistë me Përparim Krasniqi, Drejtor i Shërbimeve Publike, Komuna e Rahovecit.

publike që shkojnë nga mbrojtja e ujit dhe menaxhimi i mbeturinave; por ata akoma nuk kanë marrë ndonjë përgjigje.

Kompetenca (lloji)	Granti në 2009	Granti në 2010	Granti në 2011
Grantet totale të qeverisë (€)	€212.808.585	€242.441.701	€300.490.782
(% e buxhetit total)	18,3%	21,6%	21,2%
Granti i përgjithshëm	€87.765.219	€99.800.176	€114.209.624
	7,56%	8,91%	8,07%
Komunat e reja me shumicë serbe (Graçanica, Klokoti, Ranillugu, Parteshi)	-	€2.378.471	€2.774.781
Komunat e reja jo serbe (Juniku, Mamusha, Han i Elezit)	€1.401.844	€1.553.160	€1.767.656
Primary Education	€99.312.666	€109.030.835	€143.475.722
Primary Public Healthcare	€25.730.701	€30.169.869	€38.249.813

Sistemi aktual i financave ndërqeveritare në Kosovë ka stimulim të kufizuar për rritjen e efikasitetit dhe i mungojnë mekanizmat e duhur për barazim. Dallimet në çmimet e shërbimeve ndërmjet komunave të llojit dhe madhësisë të ndryshme, në një farë mase po ashtu përcaktohen në një masë të madhe nga kapaciteti i mbledhjes së të hyrave vetanake.

Shpenzimet e komunave sipas kategorive

Kompetenca (lloji)	Buxheti nga 2009	Buxheti nga 2010	Buxheti nga 2011
Shërbimet komunale (kompetencë vetanake)	34.468.037	47.083.715	46.628.808
	33 komuna	35 komuna	37 komuna

Prishtina si kryeqytet, është në veçanti një sfidë në vete duke u bërë peng i marrëveshjeve të partive politike. Në njëërën anë, qeveria qendrore e ka sabotuar kryeqytetin duke mos e proceduar ligjin për Prishtinën. Në anën tjetër, nuk ka presion serioz dhe të vazhdueshëm nga qeveria lokale e Prishtinës për të proceduar këtë ligj. Si rezultat, banorët e Prishtinës akoma përballen me probleme themelore që e prekin direkt efikasitetin e ofrimit të shërbimeve. Në mungesë të këtij ligji, Prishtina i ka humbur 4

milionë euro në vit, që, nëse numërohen që nga viti 2009 kur edhe është iniciuar ky ligj, mbi 12 milionë do t'ju kishin alokuar Prishtinës nëse ky ligj do të miratohej më herët. Këto fonde do të përmirësonin ndjeshëm shërbimet në një qytet që po rritet shpejt, ku qytetarët nga e gjithë Kosova, në një mënyrë apo tjetër, vijnë për shërbime. Kjo humbje në fonde ka ndikuar negativisht edhe duke dobësuar shërbimet e decentralizuara në fqinjësi të Prishtinës.

Performanca në ofrim të shërbimeve

Pavarësisht fondeve të vogla dhe mungesës së autonomisë së domosdoshme për të ofruar shërbime ashtu siç do të dëshironin, komunat, në përgjithësi kanë shfaqur përmirësim në ofrimin e shërbimeve për qytetarët e tyre krahas përparimit që ka bërë decentralizimi këtë vit. Qytetarët përditë e më shumë po shikojnë nga komuna për shërbimet dhe nevojat e tyre e jo tek qeveria qendrore (Pulsi Publik). Po ashtu, kapacitetet e komunave janë avancuar në këtë aspekt. Secila komunë vitin e kaluar ka pasur së paku një investim kapital në sistemin e tyre të kanalizimit apo furnizimit me ujë. Gjakova ka pasur tri (3) projekte të ujit dhe kanalizimit, Kamenica shtatë (7), Prishtina tetë (8) dhe Mamusha ka pasur dy (2) projekte të tilla⁴³.

Sidoqoftë, nevojat e qytetarëve për shërbime publike janë akoma të mëdha. Nëse shikojmë tek shërbimet publike, shihet se 16% e familjeve nuk kanë qasje në ujin e pijshëm, madje fshatrat afër Prishtinës janë lënë jashtë furnizimit me ujë⁴⁴. Afërsisht 30% e të gjithë kosovarëve nuk kanë qasje në sistem të kanalizimit apo sanitar. Në anën tjetër kënaqësia me shërbimet publike është shumë e ultë pasi që më pak se gjysma e qytetarëve në vitin 2009 ishin të kënaqur me kualitetin e ujit. Ata që ishin më të kënaqurit me kualitetin e ujit ishin në komunat rurale dhe ata më të pakënaqurit ishin në qytetet e vogla si Rahoveci (ku vetëm 9% e të anketuarve kanë thënë që kualiteti i ujit ishte i mirë) dhe Novobërda (14%).




Figura 1. Kënaqshmëria me kualitetin e ujit

⁴³ Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF). "Buxheti i Kosovës - 2010."

⁴⁴ UNDP, Kosovë. Mozaiku: Shërbimet Publike dhe Autoritetet Lokale në Fokus. Tetor, 2009.

Emërimi i anëtarëve të bordeve nga qeveritë lokale në ndërmarrjet publike që shërbejnë në komuna, mbetet problem, ashtu siç edhe ishte raportuar vitin e kaluar. Dragashi dhe Mamusha nuk kanë përfaqësuesit e tyre në kompaninë rajonale të ujit “Hidrojeni Jugor” të Prizrenit. Graçanica nuk është e përfaqësuar në kompaninë rajonale për shkak të nivelit jo të kënaqshëm të ofrimit të shërbimeve⁴⁵. Kaçaniku, siç edhe është thënë më herët, nuk është e kënaqur me ndërmarrjen rajonale të furnizimit me ujë dhe ka vendosur që ta krijoj kompaninë e vetë.

Komunat akoma nuk janë bërë pronarë të vërtetë të ndërmarrjeve publike të kompanive të ujit apo mbeturinave. Hisja e secilës komunë është përcaktuar nga qeveria por shumica prej tyre nuk ushtrojnë të drejtat e pronësisë. Takimet e palëve të interesuara nuk organizohen dhe ndikimi në emërimin e menaxhmentit të kompanive është akoma shumë i kufizuar. Prandaj përfitimet potenciale nga format efikase të menaxhimit të shërbimeve dhe nga pjesëmarrja e sektorit privat nuk mund të realizohet.

⁴⁵ MAPL. Raporti mbi performancën e komunave - 2010. 02 qershor, 2011.

PERFORMANCA		
Kompetenca (lloji)	Niveli i performancës ⁴⁶	Performanca
Përdorimi i tokës dhe zhvillimi	Disa vështirësi	- Akoma nuk janë krijuar stimulimet e duhura për zhvillimin e tokës dhe atij ekonomik për investime të huaja - Kufizime në përdorimin e tokës.
Shërbimet publike (kompetencë vetanake ⁴⁷)	Disa vështirësi	-Vështirësi me menaxhimin e shërbimeve publike. Problemet me emërimin e përfaqësuesve të qeverive lokale në bordet e disa ndërmarrjeve – dërgojnë rol të dobësuar të qeverive lokale në vendimet e menaxhmentit të ndërmarrjeve -Burime të pamjaftueshme për investime në infrastrukturë edhe pse ka pasur disa përmirësime - Paqartësi në lidhje me pushtetin për ushtrim të kompetencës
Arsimi publik (kompetencë vetanake)	Vështirësi të vogla	Infrastruktura ligjore e rregulluar Probleme me përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave Duhet të rritet decentralizimi fiskal për shkollat
Mirëqenia Sociale	Disa vështirësi	Vështirësi me resurset humane Infrastruktura duhet të përditësohet dhe të zgjerohet edhe në zonat rurale të

⁴⁶ Renditja është bërë në këtë kategori, nga më e mira në më të keqen: i kënaqshëm, vështirësi të vogla, disa vështirësi, shumë vështirësi dhe i pakënaqshëm.

⁴⁷ Kompetencat vetanake, me autoritet të plotë tek komunat, kompetencat e deleguara, autoriteti mbetet tek institucionet qendrore por autoritetet lokale delegohen për të ofruar shërbime dhe kompetencat e zgjeruara, të cilat u jepen vetëm tek disa komuna me shumicë serbe.

		komunave
Kujdesi i shëndetit publik		
Mbrojtja e pyjeve (kompetencë e deleguar)	E pakënaqshme	E kufizuar nga infrastruktura ligjore aktuale Nuk ka mjaft resurse financiare
Krijimi i regjistrave civil dhe bartja e zyrave kadastrale (deleguar)	Vështirësi të vogla	Në proces ⁴⁸

Potenciali për bashkëpunim ndër-komunal

Bashkëpunimi ndër-komunal në shumë pjesë të Kosovës akoma duket të mbetet me shumë një teori sesa një mjet praktik. Ky lloj i bashkëpunimit është i suksesshëm vetëm kur ka një përfitim dhe interes të përbashkët dhe të përkohshëm për lokalitetet pjesëmarrëse. Një gjë e tillë është zbatuar vetëm kur ka qenë në pyetje projektet e infrastrukturës rrugore në Kosovë. Shumë rrallë ka ndodh që ky bashkëpunim të zgjerohet edhe në fusha të tjera të interesit – si ofrimi i shërbimeve publike apo administratës së përbashkët – edhe pse duket të ketë nevojë për këtë lloj bashkëpunimi, veçmas në shërbimet si menaxhimi i mbeturinave apo zjarrfikësit. Shpesh, siç është vërejtur nga KLGI gjatë hulumtimit dhe vizitave në disa komuna, bashkëpunimi i pakët që ekzistonte ishte i natyrës jo-formale, i bazuar zakonisht në favore apo lidhje personale të ekzekutivit të komunave. Ky lloj i bashkëpunimit jo-formal ka tendenca që të ketë sukses pasi që nuk ka dyshime për përfitime dhe interesa të përbashkëta. Në të njëjtën kohë, sidoqoftë, rrallë ka dokumente të shkruara (p.sh. Memorandume të Mirëkuptimit) të hartuara nga palët e përfshira në këto raste, duke e bërë atë mjaft të vështirë për të mbikëqyrur, apo rregulluar detaje të marrëveshjeve. Në këtë aspekt KLGI i rekomandon MAPL-së që në bashkëpunim me UNDP dhe palë tjera të interesuara, duhet të organizoj një program trajnimi për shërbyes civil të përzgjedhur, në mënyrë që të krijohet një kuptim më i madh lokal mbi bashkëpunimin dhe partneritetin ndër-komunal, veçanërisht për përfitimet e këtij mjeti dhe rëndësinë e përmbajtjes në procedurat ligjore. KLGI po ashtu beson që MAPL duhet të organizoj një konferencë me komunat për këtë proces dhe të identifikoj më mirë pikat e programit trajnues të mundshëm.

Disa qeveri lokale, sidoqoftë, kanë filluar të kërkojnë bashkëpunim ndër-komunal si një mënyrë për të përmirësuar dukshëm llojet e shërbimeve që ata ofrojnë – edhe pse ka shumë mundësi në këtë drejtim dhe jo të gjitha potencialet janë përdorur. Në fushën e bashkëpunimit ekonomik, me ndihmën e Komisionit Evropian, pesë zona ekonomike rajonale janë formuar. Kjo i ka shtyrë komunat e secilit rajon që të nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët që të përkushtohen në zhvillimin e projekteve për rajonin si të tërë. Kjo praktikë është një bazë e mirë për të forcuar bashkëpunimin ndër-komunal edhe në fusha tjera si shërbimet publike, kujdesi shëndetësor dhe pyjet.

⁴⁸ Radio Urban FM. Intervistë me Raphael Naegeli, shef i njësitit për komunitete në ICO. 03 dhjetor 2010

Mbi të gjitha, përparim i rëndësishëm është bërë në krijimin e bashkëpunimit ndër-komunal. Komuna e Kamenicës ka nënshkruar tri (3) marrëveshje ndër-komunale në fushën e shërbimeve publike dhe ofrimin e shërbimeve profesionale⁴⁹. Komuna e Novobërdës ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit ndër-komunal në arsim, shëndetësi dhe inspektim. Në fakt, praktika e Novobërdës tregon se si bashkëpunimi ndër-komunal mund të jetë frytdhënës në veçanti për komunat e vogla, me kapacitete të kufizuara dhe territor relativisht të madh. Ekzekutimi i detyrave të reja në ofrimin e shërbimeve publike dhe asistencën sociale vazhdojnë të jenë akoma një sfidë për shumë komuna, pasi që ato nuk janë të pajisura me kapacitetet dhe infrastrukturën e nevojshme. Qeveritë lokale të Suharekës, Dragashit dhe Mamushës akoma janë duke u përballur me vështirësi në zbatimin e kompetencave të tyre në fushat e shërbimeve dhe asistencës sociale.

Një çështje me rëndësi është mungesa e ndonjë bashkëpunimi ndër-komunal në aspekt të planifikimit të përbashkët strategjik në komunat e Kosovës. Ka pasur raste të binjakëzimit,⁵⁰ për shembull, ndërmjet komunës së Gjakovës në Kosovë dhe komunës Pardubice në Republikën e Çekisë, duke parashikuar mundësinë e zhvillimit ekonomik strategjik dhe shkëmbimin kulturor, me mundësinë e aplikimit të përbashkët për fonde të BE-së. Në këtë aspekt KLGI e vë në pah nevojën për të konsideruar mundësitë e planifikimit strategjik për bashkëpunimin ndër-komunal në të gjitha fushat e jetës, veçanërisht në fushën e zhvillimit ekonomik dhe ofrimin e shërbimeve publike.

⁴⁹ MAPL. Raporti mbi performancën e komunave - 2010. 02 qershor, 2011

⁵⁰ Shih 3.2. të këtij raporti

Përfundim

Një sistem i decentralizuar i qeverisjes lokale ishte vënë në qendër të agjendës për reformë menjëherë pas shpalljes së Republikës së Kosovës. Zbatimi i decentralizimit në terren tregon që disa hapa janë arritur, por puna akoma nuk ka përfunduar dhe ajo çka është premtuar në letër kërkon përkrahje shtesë jo vetëm nga një ministri (MAPL) por nga një përkushtim i fortë dhe serioz nga ministrinë e linjës të përfshira në bartjen e kompetencave që i kanë pasur më herët.

Zbatimi i plotë dhe efikas i kompetencave nga komunat po has në vështirësi. Së pari, komunat kanë kapacitete të kufizuara për të përballuar të gjitha përgjegjësitë dhëna me ligj. Së dyti, ka pasur mungesë të resurseve dhe përkrahje nga qeveria qendrore, përfshirë edhe ministrinë e linjës. Si rezultat, ofrimi i duhur dhe efikas i shërbimeve është sfiduar shumë.

Bashkëpunimi ndër-komunal, si një koncept dhe mjet që mund të forcojë ofrimin e shërbimeve, forcon mobilizimin e resurseve dhe përmirëson procesin e planifikimit – nuk është duke u përdorur si duhet nga numër i duhur i qeverive lokale – edhe pse vitin e kaluar ka pasur disa iniciativa në këtë drejtim. Në fund të majit Ligji për Bashkëpunimin ndër-komunal është finalizuar nga Komisioni parlamentar për Qeverisje Lokale dhe aktualisht është në proces të miratimit nga ana e Kuvendit. Ky ligj mundet që të qartësoj dhe gjeneroj më shumë iniciativa të bashkëpunimit ndër-komunal dhe në të vërtetë të mobilizoj përkrahjen e komunitetit të donatorëve për projektet ndër-komunale.

Procesi i krijimit dhe konsolidimit të komunave të reja duket të lëviz në drejtimin e duhur. Katër komuna janë pothuajse të themeluara dhe tani kanë në funksion lidhshirin politik (kryetarët dhe asamblatë komunale) – duke ju falënderuar edhe procesit të suksesshëm zgjedhor – që është i angazhuar në konsolidimin dhe avancimin e administratës komunale. Frika e mëhershme që komuniteti serb nuk do të pranoj komunat e reja, në realitet nuk ka ndodhur pasi që krijimi dhe funksionalizimi i këtyre komunave ka prodhuar rezultate të drejtpërdrejta edhe sa i përket punësimit, në njërin anë, dhe investimeve kapitale dhe projekteve të infrastrukturës në anën tjetër. Rezultatet konkrete me investime direkte ngadalë kanë prodhuar besim për liderët e rinj. Krahas këtyre linjave, strukturat paralele të krijuara më herët në këto komuna kanë filluar të zvogëlohen, edhe pse akoma janë të pranishme, veçanërisht në fushat e arsimit dhe shëndetit primar.

Për dallim nga shembulli i mirë i krijuar në katër komunat e krijuara në vitet 2009 dhe 2010, komuna e Mitrovicës së Veriut akoma nuk është themeluar. Fatkeqësisht, tri vite pas miratimit të Kushtetutës, akoma nuk është caktuar një datë për mbajtjen e zgjedhjeve në këtë komunë. Shkalla ekstreme e fleksibilitetit në këtë drejtim, ka rezultuar në forcim të institucioneve paralele ilegale, siç edhe është dëshmuar nga investimet në infrastrukturë dhe menaxhim të shërbimeve atje.

Edhe pse Ekipi Përgatitor është krijuar në Mitrovicë në fund të vitit 2009 dhe një zyrë për Shërbime Publike është themeluar në vitin 2010, për shkak të mungesës së vullnetit politik, procesi nuk ka përparuar por në fakt është stopuar aty. Nën këto rrethana, ku nuk ka një afat të dhënë për krijimin e kësaj komune, “bisedimet” e tashme në mes të Kosovës dhe Serbisë kanë interferuar në këtë proces. Në fakt, mund të argumentohet që këto bisedime kanë kontribuar në stagnimin e themelimit të kësaj komune të re, duke e pasur parasysh që Qeveria e Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar në Kosovë

kanë hezituar të veprojnë, përderisa obstrukcionet nga zyrtarët serbë vazhdojnë të jenë të pranishme, të inkurajuara nga pozicioni i Beogradit zyrtar se Veriu do të jetë pjesë e ‘negociatave’.

Më tepër autonomi për Veriun siç është propozuar nga disa institute – shumë ndryshëm nga lloji i autonomisë së propozuar nga Pakoja e Ahtisaarit dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës – vetëm se do të rrisë problemet serioze të llogaridhënies të dobët dhe përgjegjshmërisë së një numri të madh të strukturave paralele atje.

Rekomandimet

Krijimi i Mitrovicës së Veriut ashtu siç parashihet me Kushtetutë dhe është propozuar me Pakon e Ahtisaarit

1. Nëntori i këtij viti duhet të vendoset si datë për mbajtjen e zgjedhjeve në Mitrovicën e Veriut. Qeveria duhet menjëherë të mobilizohet për të përgatitur komunitetin atje me një mesazh që komuna e re do të jetë një mundësi për shërbime më të mira dhe një qeveri lokale më proaktive dhe më të përgjegjshme – të zgjedhur nga ata pa ndonjë imponim nga qeveria e Kosovës apo Serbisë.
2. Çështja e Mitrovicës së Veriut nuk duhet të lihet në vullnetin e bisedimeve me Serbinë pasi që mund të ndryshoj sistemin e decentralizimit të vendosur bazuar në Pakon e Ahtisaarit.

Reforma e legjislacionit lokal

3. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale duhet të amandamentohet në mënyrë që të shmangen disa përplasje në interpretim sa i përket autoritetit lokal dhe qendror në komuna.
4. Në veçanti, Grupi Punues për Decentralizim duhet të harmonizoj legjislacionin në mënyrë që mos të ketë vend për keqinterpretime në fushat specifike të shërbimeve publike, pronësisë së tokave publike dhe zhvillimit ekonomik.
5. Qeveria e Kosovës duhet të ri-draftoj dhe paraqesë Ligjin për Prishtinën në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ky ligj kërkohet dhe rrjedhë nga Kushtetuta e vendit.

Përmirësimi i ofrimit dhe efikasitetit të shërbimeve

6. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve në nivelin lokal duhet të jetë prioritet i ri dhe ministritë e linjës duhet të ofrojnë pavarësi të plotë për komunat për të kryer detyrat e dhëna.
7. Ministritë e linjës duhet të rifokusojnë përkushtimin e tyre dhe të mobilizohen së bashku me MAPL-në për të ndihmuar komunat që në mënyrë efikase të zbatojnë kompetencat e reja të marra në sektorët e arsimit, shëndetësisë, shërbimeve lokale dhe zhvillimit ekonomik.
8. Duhet të rriten përpjekjet nga Ministritë e Arsimit dhe të Shëndetësisë për të forcuar komunat e reja për të marrë përsipër ofrimin e shërbimeve përkatëse në arsim dhe shëndetësi, kështu që strukturat paralele aktuale zhduken dhe të njëjtave u ofrohet mundësia për të kontribuar në një sistem të ri efikas të integruar.
9. Asistenca financiare për komunat, jo vetëm për grantet specifike, duhet të rriten në mënyrë graduale, duke pasqyruar rritjen e kompetencave në vitet e fundit. Buxheti i përgjithshëm për komunat duhet të shkojë në 35% të buxhetit të përgjithshëm brenda tri viteve të ardhshme dhe grantet specifike duhet të shkojnë në 12% të buxhetit të Kosovës. Një gjë e tillë do t'u mundësonte komunave që të ushtrojnë vetë përgjegjësitë e reja të tyre. Ofrimi i shërbimeve efikase nuk duhet të rrezikohen nga buxhetet e vogla.

Bibliografia

- Blaku, S. "Tri komuna kompletohen me dokumentacion" Kosova Sot, August 1st, 2010. Kosova Sot.
- Hajnal, Gyorgy & Peteri, Gabor. Reforma Lokale në Kosovë. Forumi 2015. Shkurt, 2010.
- ICG. 12 maj 2009. "Integrimi i serbëve në Kosovë", Europe Report N°200
- ICG. 14 mars 2011. "Veriu i Kosovës: Sovraniteti i dyfishtë në praktikë" Europe Report No.
- Faqja elektronike e ICO-së. Zbatimi i Pakos Gjithëpërfshirëse të Ahtisaarit – Gjendja e implementimit.
- Intervistë me Avni Sahiti, Drejtor i departamentit për Hulumtim dhe reformë të qeverisjes lokale, MAPL. 29 mars, 2011.
- Intervistë me Hysen Jerliu, Drejtor i Shërbimeve Publike, Komuna e Kamenicës. (përmes emailit).
- Intervistë me Nebojsa Milovanovic, Drejtor i Administratës, Komuna e Graçanicës. 14 prill 2011.
- Intervistë me Nebojsa Periq, Këshilltar i Kryetarit të Graçanicës.
- Intervistë me Perparim Krasniqi, Drejtor i Shërbimeve Publike, Komuna e Rahovecit. (përmes emailit).
- KiM Radio. Kontradikta në lidhje me komunat e decentralizuara. 2 shkurt 2011.
- Koha Ditore. 10 janar 2011. F. 14
- Koha Ditore. 14 prill 2011. "Dëshirojnë të bëhen komuna". F. 13.
- Koha Ditore. 27 nëntor 2010. Kisha Ortodokse Serbe në Ranillug. F. 14.
- Koha Net. 05 janar 2011. Komuna e Ranillugut shënoi një vjetorin e themelimit.
<http://www.koha.net/index.php?cid=1,8,45587>
- Kosova Sot. 27 mars 2011. F. 3
- Kosova Sot. 15 janar 2011. F. 29
- Kosova.info. <http://kosova.info/2010/11/kryetari-i-komunes-se-kllokotit-shkarkon-zevendesin-e-tij/>,
qasur për herë të fundit me 24 prill 2011
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040), http://www.assemblykosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_en.pdf, qasur me 15 mars, 2011.
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF). "Buxheti i Kosovës 2010."
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. 2011. Raporti i progresit mbi themelimin dhe zhvillimin e komunave të reja. F. 12, http://mapl.rks.gov.net/repository/docs/anglisht_raport_optimized.pdf.pdf

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Qershor 2011. Raporti mbi performancën e komunave
- Faqja elektronike e komunës së Graçanicës. <http://kk.rks-gov.net/gracanice/News/Kosovski-srbi-treba-da-budu-treca-strana-u-pregovo.aspx>
- Faqja elektronike e komunës së Klllokotit. <http://kk.rks-gov.net/klllokoti/News/3-milion-investime-ne-vitin-2010-ne-komunen-e-re-t.aspx>
- Faqja elektronike e komunës së Klllokotit. <http://kk.rks-gov.net/klllokoti/News/Zbutja-e-papunesise-sfide-per-komunen-e-re-te-Kllo.aspx>, qasur për herë të fundit me 21 prill 2011
- Faqja elektronike e komunës së Klllokotit. Komuna e Klllokotit behet me strategji Zhvillimore. <http://kk.rks-gov.net/klllokoti/News/Komuna-e-Klllokotit-behet-me-strategji-zhvillimore.aspx>
- Faqja elektronike e komunës së Ranillugut. Mbledhja e nëntë e Kuvendit Komunal të Ranillugut. <http://kk.rks-gov.net/ranillug/News/Eshte-mbajtur-seanca-e-nente-e-rregullte-e-Kuvendi.aspx>
- UNDP. Raporti i Pulsit publik. Prishtinë, f. 51.
- Sabedini, Musa. 30 dhjetor 2010. Lajm. Përfitues edhe fshatrat shqiptare. F.29
- UNDP-Kosovo. Mozaiku: Shërbimet komunale dhe autoritetet lokale në fokus. Tetor 2009.

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale
Address: Fehmi Agani, 25/1 Prishtinë, Kosovë, 10000
E-mail: klg.institute@gmail.com
Tel: +381 38 225 625 or 044-640164
Web faqja: www.klg-institute.org